



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d e Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2023, miratoi këtë

**V E N D I M**  
**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR SHËRBIME SOCIALE NË KOMUNËN**  
**E PRISHTINËS, 2023-2025**

**Neni 1**

Miratohet Vendimi i Planit të veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

**Neni 2**

Qëllimet kryesore të Planit të veprimit për shërbime sociale janë: shërbime sociale të integruara për grupet e cenuara, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara (të mitur dhe të rritur), zhvillimi i kapaciteteve dhe burimeve njerëzore, të këshillimit dhe digjitalizimi i bazës së të dhënave, dhe mbështetje për strehim për grupet në nevojë për mbrojtje sociale.

**Neni 3**

Përfitues të këtij Plani të veprimit janë fëmijët, të moshuarit, të rinjtë në konflikt me ligjin, ata që konsumojnë dhe përdorin alkool dhe droga të tjera, njerëzit me sëmundje kronike, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët dhe të rinjtë me vështirësi në të mësuar ose probleme të shëndetit mendor, dhe ata që janë në rrezik abuzimi dhe/ose neglizhimi që rrjedhin nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe dhuna në familje.

**Neni 4**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani i veprimit për shërbime sociale në Komunën e Prishtinës, 2023-2025.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përgjegjëse.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-550/01-69243/23, më 03.04.2023

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Fehmi Kupina

